




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Visar Shurdhaj B.I.
Emri Tregtar: N.T.SH. "Bledi"
Numri Unik Identifikues: 811152909
Pronar: Visar Shurdhaj
Operatori i Shpërndarjes: N.T.SH. Bledi
Adresa: Rr/Banjë-Malishevë, pn



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës së KPM-së për operatorin e shpërndarjes N.T.SH. Bledi, me seli në Banjë,
Komuna e Malishevës

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. N.T.SH. Bledi është operatorë i shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale përmes sistemit kabllorë, me seli në Banjë, Komuna e Malishevës. KPM, me datën 30 tetor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorë të shpërndarjes N.T.SH. Bledi.
3. Me datën 30 tetor 2023, skadon afati i licencës së OSH N.T.SH. Bledi, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese, dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mailit, ju ka dërguar shkresë të gjithë Operatorëve të Shpërndarjes të cilave afati i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe operatorit N.T.SH. Bledi, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj, në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
5. Më datën 9 gusht 2023, operatori i shpërndarjes N.T.SH. Bledi ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi


6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në përcakton: "Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio-vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të

drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

7. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM ka njoftuar operatorin e shpërndarjes N.T.SH. Bledi lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
8. Komisioni konstaton se operatori i shpërndarjes N.T.SH. Bledi, përmes kërkesës me shkrim, ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së shpërndarjes së ofrueseve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuele.
9. Komisioni konstaton se N.T.SH. Bledi, lidhur me obligimet financiare ndaj KPM - së, ka lidhur marrëveshje me KPM për shlyerjen e borjeve me këste (në 5 këste).
10. Komisioni konstaton se N.T.SH. Bledi, ka kryer pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
11. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së N.T.SH. Bledi,
12. Komisioni konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga operatorit të shpërndarjes N.T.SH. Bledi të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
13. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së operatorit të shpërndarjes N.T.SH. Bledi është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së N.T.SH. Bledi i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon operatori i shpërndarjes.

Vendim

14. Komisioni merr vendim për ripërtëritjen e licencës së operatorit të shpërndarjes N.T.SH. Bledi, për të ushtruar veprimtarin e shpërndarjes së ofrueseve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale në Republikën e Kosovës.
15. Licenca e KPM-së për operatorin e shpërndarjes N.T.SH. Bledi do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 30 tetor 2023.
16. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, shtrirja e rrjetit të operatorit të shpërndarjes N.T.SH. Bledi, si dhe lista e kanaleve sipas katalogut që është pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.10.2023

Data